



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 906/ 1 prot.

Datë 07.04.2025

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E
OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT
NGRIHEN PRETENDIME

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr REF-36522-01-31-2025, me objekt: “Blerje Inerte”, me fond limit 161,080,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 05.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugeve dhe Ndriçimit Publik Tirane
- Ankimues:** BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” SHPK me NIPT K47103804 dhe K94016202U dhe adresë: Elbasan, Gramsh, Sporti
- Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Përgjithshme e Rrugeve dhe Ndriçimit Publik Tirane me adresë: Rruga “5 Maji”, Tiranë
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “Ouen” SHPK me NIPT K175292150 dhe adresë: Tirane, Minibashkia Nr.8 Tirane, Rruga e Dibres, "Kompleksi Halili" Kati II-te, Zona Kadastrale Nr.8370, Nr. Pasurie 11312-N52, Ambient pune me Sip. 27 m2.

Në datën 05.04.2025 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5217 dhe me nr.906 prot., datë 07.04.2025 e BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” për procedurën e prokurimit procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr REF-36522-01-31-2025, me objekt: “Blerje Inerte”, me fond limit 161,080,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 05.03.2025, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugeve dhe Ndriçimit Publik Tirane.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Ouen” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) **pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.**”

Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat BOE “Viante Konstruksion” SHPK dhe “Kegli-Duri” me anë të ankesës me numër ankimi elektronik A/2025/5217 dhe me nr.906 prot., datë 07.04.2025, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Ouen” SHPK.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik “Ouen” SHPK të kriterëve si më poshtë:

-Dyshojme se ky operator ekonomik nuk ka dhënë informacion konkret për plotësimin e disa prej rubrikave të mësipërme që lidhen me plotësimin e deklaratave, kërkesave të përgjithshme të kualifikimit duke ju referuar autoritetit. Konkretisht për rubrikat e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit Pjesa II SHKAQET E PËRJASHTIMIT A: DEKLARAT PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT OPERATORI EKONOMIK “OUEN” SH.P.K, nuk ka dhënë informacionin si më poshtë:

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit t? posaá?m n? rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.
Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1

të lpp-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të lpp-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare

nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohej për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka cuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata

publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të agjencisë së prokurimit publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

*Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.
Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

Kemi dyshimet tona se operatori ekonomik OUE sh.p.k nuk ka plotësuar sipas të gjitha të dhenave formularin përmbledhës të vetdeklarimit. Operatori ekonomik ofertues Është subjekti më i interesuar në plotësimin e dokumenteve të tenderit me saktësi dhe përpikëri, më qëllim që oferta e tij të rezultojë e vlefshme. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Ligjvënësi me qëllimin për të lehtësuar punën e operatorëve ekonomikë në përgatitjen në kohë të ofertave, ka përcaktuar se, në fazën e parë të vlerësimit të ofertave operatorët ekonomikë mund të plotësojnë formularin përmbledhës të vetdeklarimit në vend të paraqitjes së disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta. Por sa me shpejt operatori ekonomik Ouen shpk nuk ka plotësuar me informacionin e kërkuar formularin përmbledhës të vetdeklarimit, duke mos dhënë informacion të plotë konkretisht në pjesën II: Shkaqet e përjashtimit A: Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit; C: Deklarata mbi konfliktin e interesit, pjesën III kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit A: Deklarata në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës: dhe B: Deklarate për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen). Operatori ekonomik Ouen shpk nuk ka plotësuar në mënyrë të saktë të gjithë, deklaratën e lartpërmendur duke mos përcaktuar në mënyrë të saktë çdo dokument që do të dorëzohet në përmbushje të rubrikave të kësaj deklarate si dhe institucionin që do të lëshojë dokumentin përkatës.

- Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

- 2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesi raport analizë ose raport testimi për mallrat objekt prokurimi, të lëshuar nga laborator i akredituar, brenda 6 muajve nga data e hapjes së ofertave.

- 2.3.7 Dëshmi për mjetet e transportit, që ka në dispozicion apo mund të vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

Mjetet	Sasia	Gjendja
<i>Kamion me kapacitet mbajtës minimumi 14 ton</i>	<i>3 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kamionçinë me kapacitet mbajtës 1.5 - 2 ton</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kamion me vinç</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) certifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme).*
- Për mjetet e marra me qira duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit,(i vlefshëm); e) certifikatën e për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme) si dhe kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj, i cili duhet të jetë deri në përfundim të marrëveshjes kuadër.*
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të dallohet qartë marka dhe targa e mjetit.*
- Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*

-Gjthashtu BOE ankimes shfaq pretendime për operatorin ekonomik “Ouen” SHPK si vijon:

[...] Kemi dyshimet tona se ky operatore nuk ka dorezuar te gjithë dokumentacion fizik prane autoritetit kontraktor ne permbushje te dispozitave ligjore te sipercituara konkretisht kemi dyshime se ky operator nuk ka dorezuar dokumentacion te sakte per permbushjen e pikes b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, ë nenit 76, të lpp-së; dhe c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose q? ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk ?sht? ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; pra per permbushjene e ketyre pikave duhej te dorezonte deshmi penaliteti nga Ddrejtoria e Burgjeve, dhe vertetime nga gjykata dhe prokuroria kerkojme qe te behet verifikimi i te dhenave te personave te deklaruar ne QKB me dokumentat e dorezuara vizikisht, nese eshte dorezuar per te gjithë personat deshmi penaliteti dhe vertetime nga gjykata dhe prokuroria per te vertetuar permbushjen e ketyre pikave. Gjithashtu ne piken ç) parashikohet qe operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale; te verifikohet eshte paraqitur dokumentacioni i sakte per plotesimin e kesaj pike nga subjekti. Ne lidhje me piken e) ne te cilen thuhet se operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e republikës së Shqipërisë; Referuar Qendres Kombetare te Biznesit konkretisht ekstraktit historik te ketij subjekti rezulton se ky OE e ushtron aktivitetin e tij ne 2 vende te ndryshme kokretisht 1- Rruga e Dibres, “Kompleksi Halili” kati II-te, zona kadastrale nr.8370, nr. pasurie 11312-n52, ambient pune me sip. 27 m2, Minibashkia nr.8 Tirane dhe 2-

lagjja Shemri, rruga Nacionale, Shemri-Kukes km2, zona kadastrale nr.3335, nr. pasurie 593/1, Kukes. Kerkojme te verifikohet vertetimi i OSHEE i paraqitur nga ky operatore nese eshte dorezuar per te dyja vendet e ushtrimit te aktivitetit dhe nese jane paguar te gjitha detyrimet e maturuara te energjise elektrike nga ky operator per secalin vend te ushtrimit te aktivitetit.”

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 07.04.2025.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetari
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri